

## Editorial

# Lindja dhe zhvillimi i fikhut dhe i katër shkollave të njohura juridike islame

Fikhu në kohën e Profetit (alejhi salatu ue selam) nuk nuk ka qenë i regjistruar në libra dhe i sistemuar sipas kapitujve të caktuar. Myslimanet e parë jetuan pranë Profetit dhe ai ishte burim referimi për çështje të ndryshme të jetës së tyre. Ai i drejtonte besimtarët, iu përgjigjej pyetjeve dhe, kështu, i qetësonte mendjet dhe zemrat e tyre. Shokët e tij gjithashtu shikonin veprimet e tij dhe i zbatonin ato pa bere dallimin se cili prej tyre ishte element bazë në to dhe cili ishte i pëlqyer. Pas vdekjes së Profetit (alejhi salatu ue selam) takimet konsultative ishin të shpeshta dhe shumica e vendimeve juridike dhe politike merreshin bashkërisht dhe shumë shpesh të mbështetura në konsensusin e sahabëve. Këta te fundit, shpesh herë, ngurronin të jepnin përgjigje (fetva) në mënyrë individuale dhe përpiqeshin që ta dërgonin pyetësin te ndonjë shok tjetër i Profetit (alejhi salatu ue selam) të cilin e konsideronin më të kualifikuar. Në këtë mënyrë filluan të dalin në pah disa figura të dalluara të cilat ishin pikë referimi për t'i dhënë zgjidhje situatave të ndryshme në atë kohë, si Abdullah ibn Mesudi, Omeri, Muadh ibnu Xhebeli, Aliu, Zejd ibn Thabit, Osmani, Ebu Hurejra, Aishja, Abullah ibn Abasi, etj. Megjithatë shokët e Profetit (alejhi salatu ue selam) ishin të interesuar për të përvetësuar numrin më të madh të mundshëm të thënieve të Profetit (alejhi salatu ue selam), veprimeve të tij, si dhe gjykimet sipas situatave të ndryshme, duke i logjikuar ato dhe duke u munduar që të njiheshin me veçoritë themelore të tyre. Kështu, në këtë mënyrë, secili prej tyre formoi idenë e tij në lidhje me këtë trashëgimi të bollshme të Profetit (alejhi salatu ue selam), duke konsideruar ndjekjen e disa prej thënieve dhe veprimeve të tij të pëlqyera, disa të tjera të detyruar dhe të fundit të lejuar apo të shfuqizuar me ndonjë thënie ose veprim të mëvonshëm. Sahabët pasi u shpërndanë në vende të ndryshme, të gjithë këtë informacion të grumbulluar ata ia përcollën pasardhësve të tyre, tab'inëve, ku secili prej tyre memorizoi thëniet profetike që mundi, si dhe mendimet e ndryshme të shokëve të Profetit, duke i dhënë përparësi disa prej tyre dhe duke lënë mënjanë në të njëjtën kohë disa mendime të tjera. Në këtë mënyrë edhe tab'inët filluan të bënin përzgjedhjet e tyre në çështje të ndryshme juridike dhe se çdo vend karakterizohej nga figurat më me zë ku më vonë u bënë edhe referencat e atyre vendeve. Ndër ta dallohej Said ibn Musejebi, Ikrime, Ata ibn Ebi Rabaha, Zuhriu, Tavus ibn Kejsan, Hasen El-Basri, Esved ibn Jezidi, Ibrahim en-Nekhai, Alkometu ibn Kajs, Mekhuli etj., respektivisht të ndarë në Mekë, Medine, Kufë, Basra dhe Sham. Secili prej të lartpërmendurve mblodhi temat e fik'hut dhe në çdo kapitull ata kishin bazat dhe preferencat e tyre nga mendimet e sahabëve. Said ibn Musejebi dhe nxënësit e tij p.sh. mendonin se fik'hu i mekasve dhe medinasve ishte më i godituri dhe baza e medh'hebit (shkollës juridike) të tyre ishte fetvatë dhe gjykimet e Omerit, Osmanit, Ibn Omerit, Aishes, Ibn Abasit. Sipas tij nëse fukahatë (juristët) e Medinës vendosnin unanimsisht për ndonjë çështje, ai dhe nxënësit e tij kapeshin fort pas tij dhe nuk shikonin mendimet e tjera. Ndërsa Ibrahim en-Nekhaiu dhe nxënësit e tij mendonin se Abdullah ibn Mesudi ishte më i saktë sesa të tjerët në çështjet e fik'hut. Baza e medh'hebit të tij ishin fetvatë e Abdullah ibn Mesudit, Omerit dhe Shurejhut,

si dhe gjykimet e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për fukahatë e tjerë. Gjejmë pra kështu një shpërndarje gjeografike të mendimeve juridike, ku secila zonë kishte juristët e saj, mendimet e saj si dhe bazat dhe metodikën e studimit të Kuranit dhe Traditës Profetike, të cilat u transmetuan me vonë te fukahatë më në zë, që ka njohur Islami. Ndër këto shkolla juridike të formuara ishin medh'hebi i Ebu Hanifes në Kufë, i Euzait në Siri, i Malikut në Medine, i Zejdit në Kufë dhe Vasit, i Lejthit në Egjipt, i Sufjan Theuriut në Kufë, i Shafiut në Bagdad dhe Kajro, i Ahmed Ibn Hanbelit në Bagdad, i Ebu Davudit në Kufë dhe i Taberit në Egjipt dhe Taberistan. Secili prej këtyre fukahave gjatë jetës së tij ka dhënë një kontribut të veçantë dhe ka ndihmuar në zhvillimin e të kuptuarit të burimeve islame. Secili prej tyre konsiderohet si themelues i një medh'hebi, ku disa prej tyre janë zhdukur gjatë historisë, kurse shkollat e tjera janë edhe sot të pranishme në të gjithë botën islame. Imamët e katër medh'hebeve të njohura dhe nxënësit dhe pasuesit e tyre kane dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e lëndës së fikhut, duke vendosur kriteret dhe bazat e kuptimit të Kuranit dhe Traditës Profetike për hulumtuesit e lëndës së fikhut. Ata mblodhën dhe sistemuan temat dhe kapitujt e tij, duke e thjeshtëzuar këtë lëndë për të gjithë ata të cilët nuk kanë kapacitetin për të nxjerrë konkluzione drejtpërsëdrejti nga Kurani dhe Suneti. Vihet re që në kohën e katër imamëve dhe sidomos ndjekësve të tyre lulëzoi lënda e fikhut ku iu dha edhe forma e saj e fundit. Në këtë periudhë ndeshemi me librat që pasqyrojnë mendimet e secilit imam dhe shumë çështje të pa cekura nga vetë ata, por kjo në bazë të kriterëve të vendosura nga secili imam.

Asnjëri nga imamët nuk e ka konsideruar veten të pagabueshëm, dhe askush nuk ua ka atribuuar këtë cilësi atyre. Ata kanë qenë muxtehidi dhe kanë kërkuar të vërtetën, aq sa kanë qenë mundësitë e tyre njerëzore. Për këtë shkak ata shpesh herë linin një mendim dhe pranonin një tjetër, në përputhje me ekzistencën dhe fuqinë e argumentit. Na përcillet se Ebu Hanifja ka thënë: "Ky është mendimi im dhe gjëja më e mirë që ka arritur arsyeja ime, prandaj kush vjen me mendim më të mirë, ne do ta pranojmë atë". Imam Maliku ka thënë: "Unë jam njeri, si njerëzit e tjerë. Gjykoj me drejtësi, por edhe gaboj, prandaj vendosini fjalët e mia në peshoren e Kuranit dhe Sunetit". Ndërsa nga Shafiut përcillet se ka thënë: "Nëse ndonjë hadith kundërshton mendimin tim, atëherë flakeni mendimin tim për muri, e kur të shihni ndonjë argument të marrë, dijeni se ai është opinionimi im individual". Nuk duhet të harrojmë, se këto fjalë duhet vënë vendin e duhur, sepse këto thënie të ndritura ata ua drejtonin nxënësve të tyre ose juristëve islamë, të cilët kanë arritur një nivel të lartë dije dhe sidomos në lëmin e fik'hut. Ndryshe këto thënie të keqkuptuara u hapin rrugën edhe atyre që kanë lexuar disa librat të fikhut, apo kanë dëgjuar disa hadithe, e më pas i kundërvihen fjalëve të dijetarëve duke mos kuptuar arsyet e konkluzioneve të tyre.

Sot vihet re, se në libra dhe në hulumtime përmenden më shumë mendimet e katër medh'hebeve, ndërsa mendimet e medh'hebeve të tjera, që nuk janë ruajtur nuk u dëgjohet zëri me forcë. Cila është urtësia që Allahu ka ruajtur vetëm këto shkolla, ndërsa të tjerat nuk përmenden vetëm se në çështje sporadike? Kësaj pyetje i përgjigjet Ibn Tejmije, i cili duke

përcjellë fjalën e Ebul Hasen El Kerkhiut thotë: "...ata që përmendëm, veç imamëve të shkollave të njohura, ishin shembull i mirë në kohën e tyre, por më pas shkollat e tyre u shkrinë dhe u bënë pjesë e mendimeve të imamëve të shkollave të njohura. Ibnu Ujejne ishte shembull i mirë, por ai nuk la literaturë rreth mendimeve të tij në lëmin e fikhut. Ata që shkruan ishin nxënësit e tij, si Shafiut, Ahmedi, Is'haku dhe në këtë mënyrë mendimet e tij u bënë pjesë e mendimeve të këtyre të fundit. Ndërsa Lejth ibn Sa'dit nxënësit e tij nuk i shërbyen mendimeve të tij për t'i mbledhur ato, megjithatë siç thotë Shafiut, mendimet e tij janë të ngjashme me ato të Malikut dhe Sufjan Theuriut. Kurse Euzai, shumica e

Nga Ervin QYLAFKU


mendimeve të tij i bashkëngjiten mendimeve të Malikut, Shafiut dhe Theuriut. Gjithashtu përzgjedhjet e Is'hakut janë të ngjashme me ato të Ahmedit. Po ashtu edhe mendimet e Ebu Zur'es, Ebu Hatimit dhe Buhariut janë të ngjashme me ato të Ahmedit". Kështu pra, kur përmenden mendimet e katër imamëve të njohur kjo nuk do të thotë se ne i qëndrojmë fanatikë vetëm mendimeve të tyre dhe anashkalojmë çdo mendim tjetër, por në të njëjtën kohë këto mendime pasqyrojnë edhe mendimet e imamëve, të cilët nuk kanë lënë libra, ku të tregohen përzgjedhjet e tyre në lëmin e fikhut.



**MBLEDH ZEKATIN TUAJ**

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë  
 Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160  
 BKT Banka Kombëtare Tregtare  
 Nr. i llogarisë : 52416329

Për zekatin në lekë:  
 IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB  
 Llogaria në lekë:  
 IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA  
 Llogaria në Euro:  
 IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO  
 Llogaria në Dollarë:  
 IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA



**Fq 3 / Radikalizëm Islam, apo injorancë radikale ndaj Islamit**

Nga Enklid PELARI

**Fq 6 / Pluhur dhe kujtime të vvarësh në kampin e refugjatëve të Zatarit në Jordani**

Nga Shaima HALILI

# Fetva / Ndikimi i ushqimit në pastërtinë e kafshëve të fermave dhe lejimin e tyre

Padyshim që ushqimi duke qenë pjesë e rëndësishme e përditshmërisë njerëzore është trajtuar nga Feja Islame me përparësi të veçantë. Përveç përcaktimit se cilat janë ushqimet e lejuara dhe ato të ndaluara legjislativoni islam është marrë edhe me aspektin sesi rriten dhe ushqehen produktet që ne hamë. Kështu është i njohur fakti se disa kafshë, si p.sh. pulat, mund të vetë-ushqehen me produkte të papastra, apo produkte që konsiderohen të ndaluara nga Feja Islame. Një kafshë e tillë në terminologjinë islame quhet xhelale, dhe për të ka dispozita të veçanta, që e trajtojnë. Në këtë studim autori merr në shqyrtim pikërisht këto lloj kafshësh që ushqehen nëpër ferma me koncentrate, të cilat kanë në përbërjen e tyre përbërës të ndaluar fetarisht.

Studimi në fjalë është i ndarë në disa tema, ku më kryesoret janë:

- Rëndësia e ushqimit hallall dhe lidhja e tij me besimin.

- Referimi për hallallin dhe haramin në lidhje me ushqimet.

- Llojet e ushqimeve sipas ndarjes hallall dhe haram.

- Gjykimi për konsumimin e pulave dhe kafshëve të fermave. etj.

Autori në studimin e tij pasi ka shpalosur argumentet fetare dhe ka diskutuar opinionet e shkollave ndryshme të fikhut islam dhe të dijetarëve ka arritur në këto përfundime, të cilat ai i sheh si më të sakta duke thënë:

"Nga shpalosja e opinionëve të fukahave dhe diskutimi të tyre del në pah, se opinioni i shumicës së hanefive dhe shafive, se mish i xhelale-s është mekruih (i papëlqyeshëm) të konsumohet, është opinioni që i përgjigjet më së shumti objektivave të Sheriatit. Ndërsa opinioni që thotë në mënyrë absolute, se kjo është haram çon në konsiderimin haram të asaj që Allahu e ka bërë hallall ngrënien e saj, ndërkohë që diçka të vlerësohet si haram për të duhet një argument i saktë, çka në rastin tonë nuk kemi diçka të tillë. Gjithashtu edhe opinioni që thotë, se në mënyrë absolute xhelale është hallall shpie në lënien pas dore të haditheve të ndalimit, të cilat përforcojnë njëra-tjetrën (transmetimet mursele me ato musnade). Ndërsa opinion, që e vlerëson konsumimin e xhelales si mekruih tenzih (e papëlqyeshme ku lënies i jepet përparësi) merr në konsideratë hadithet, që përcillen për këtë çështje, në veçanti pasi kemi njohur arsyen e ndalimit (iletu nehji), siç e kemi paraqitur në këtë studim (që është papastërtia dhe ndryshimi për shkak të saj). Kështu që mund të themi, se ngrënia e mishit të kafshëve, të cilat në ushqimin e tyre kanë përbërës të papastër është hallall, përderisa lënda e papastër nuk përbën shumicën e përbërësit apo tërësisht atë dhe përderisa nuk provohet dëmi i sigurt për shëndetin."

## "KONKLUZIONI:

Nga ajo që kemi paraqitur në studim del e qartë, se lejohet të hahet mish i kafshëve dhe shpendëve, të cilat nuk kanë si ushqim dominues koncentrate të përziera dhe në veçanti kur kjo sasi koncentratit i nënshtrohet trajtimit të mjaftueshëm pastrues, për aq sa e vlerësojnë këtë ekspertët e fushës, të njohur si njerëz të sinqertë dhe të devotshëm. Po kështu, lejohet konsumimi i këtij mishit pasi kafshët të jenë detyruar të ushqehen vetëm me ushqim (të pastër), që nuk përmban koncentrate për një periudhë të atillë sa të pastrohet mish i tyre dhe të shpërbëhen përbërësit që mund të jenë të papastër, ku të mos ngelet papastërtia

dhe as erë si pasojë e këtij lloji ushqimi. Nuk mendoj se gjykimi ndryshon, për papastërtinë e ushqimit të kafshëve, nëse ky ushqim i jepet kafshës nga vetë njeriu apo ajo shkon vetë në gjendje të lirë tek ai, përderisa arsyeja e ndalimit bie duke kufizuar ushqimin e kafshës apo duke e trajtuar atë, për të dyja rastet.

## REZULTATET E STUDIMIT:

Pulat dhe kafshët e fermave, të cilat jetojnë me koncentrate janë të pastra dhe të lejuara të hahen, për arsyet e mëposhtme:

1. Lëndët që nxirren nga kockat, thundrat, (lëkura) dhe puçlat e kafshëve të ngordhura, të cilat janë pjesë e përzierjeve të ushqimit të kafshës janë të pastra. Ato konsiderohen si të pastra në medhhebin hanefi, një pjesë e malikive dhe një opinion tek hanbelitë.

2. Edhe nëse merret opinioni i shafive, hanbelive dhe të tjerëve, se këto lëndë janë të papastra, ato nuk ndikojnë në pastërtinë e kafshëve që i hanë ato, për dy arsye:

a) Asia e këtyre përbërësve të papastër në tërësinë e masës së ushqimit të përzier nuk e kalon masën 10 %. Kjo përqindje nuk ndikon në mishin e kafshës, sepse është shumë e vogël.

b) Sipas studimeve të thelluara dhe dëshmisë së specialistëve të fushës kjo përqindje paramendohet, se trajtohet me metoda vlimi të përparuar, të cilat zhdukun efektin e mikrobeve të dëmshme, duke i kthyer këto lëndë në lëndë të tjera, të cilat ndryshojnë në emër, cilësi dhe përbërje, kështu që në gjykimin e sheriatit edhe dispozita ndryshon, me anë të asaj, që në gjuhën e sheriatit quhet istihale (shndërrim).

3. Shumica e fukahave e shohin të lejuar përfitimimin nga objektet e papastra dhe të ndaluara, kur kjo vjen nëpërmjet rrugës së ushqimit të kafshëve apo bimëve.

4. Si burim bazë në konsiderimin e një ushqimi hallall apo haram është Sheriatit me referencat e tij të sakta dhe jo vlerësimi, se kjo është e mirë apo e keqe në bazë të arsyes njerëzore, kështu që përderisa nuk kemi ndonjë argument, që e ndalon ngrënien e mishit të bagëtisë dhe pulave nuk ka vend që të flasim për ndalimin e tyre thjesht për shkak të paraqitjes së një dyshimi, e për më tepër kur kemi argument të qartë nga Suneti, që e lejon ngrënien e tyre.

5. Ajo që në origjinë është e lejuar mbetet e tillë përderisa prej saj nuk vjen ndonjë dëm trupor apo mendor. Shembull të këtij dëmi kemi rastin e asaj që u quajt "lopa e çmendur" në Britani, që erdhi si pasojë e shtimit të përqindjes së përbërësve shtazorë në ushqimin e koncentruar, që u jepej lopëve. Specialistët këtë çrregullim e shpjeguan, duke thënë se natyra lopës është të jetojë me ushqime bimore dhe nëse ajo ushqehet me të njëjtin ushqim, që ushqehen edhe egërsirat, pra me mishra, në të nxitet natyra e egërsirave. Pra nëse koncentratet e ushqimit të kafshës kanë përbërje, që i shkaktojnë dëme pulave, në këtë rast edhe pulat janë haram të konsumohen; natyrisht ky gjykim vjen si pasojë e këtij shkaku kalimtar, përndryshe ky gjykim bie.

6. Mishrat e pulave dhe kafshëve që kultivohen nëpër ferma konsiderohen të pastra dhe hallall, duke bërë kështu analogji me xhelale-n. Këto mishra janë të pastra, por të papëlqyeshëm (mekruh) për konsum. Këtë gjykim kanë të gjitha medhhebet me përjashtim të hanbelive, të cilët janë të mendimit se këto mishra janë haram, por gjithsesi të gjithë bien dakord, se kushti që ndalesa të bjerë është: izolimi i kafshës me ushqim të pastër derisa të zhduket papastërtia

Nga Dr. Muhamed Falih Mutalik Beni Salih  
(Studim i botuar në revistën "Studime Bashkëkohore të Fikhut")

dhe të largohen erërat e këqija. Kjo do të thotë se nëse këto kafshë nuk shfaqin papastërti dhe as erë të keqe, nuk ka arsye të thuhet për to se janë kafshë të papastra. E njëjta gjë vlen edhe për pulat që jetojnë me ushqim koncentrat dhe në mishin e tyre nuk shfaqen gjurmë të papastërtisë, pra ato padyshim ngelen të pastra dhe hallall për t'u ngrënë.

## SUGJERIME:

Edhe pse studimi erdhi në përfundimin se mish i pulave dhe kafshëve të fermave është i pastër, duke u nisur nga ndjeshmëria e madhe që ka të muslimanët kundër përzierjes së elementëve të pastër me ata të papastër, të atyre hallall me ato haram nga disa pronarë fermash, që për shkak të neglizhencës fetare dhe moskokëçarjes nuk i kushtojnë rëndësi rregullave të hallallit dhe haramit në ushqimin që ata u japin kafshëve, autori i këtij studimi sugjeron si më poshtë:

1. Fabrikat e përpunimit të ushqimit të kafshëve duhet domosdoshmërisht të mbikëqyren seriozisht nga organet e interesuara, sesa i plotësojnë ata standardet shëndetësore, bujqësore, industriale dhe cilësore, duke i detyruar këto fabrika t'i përmbahen standardeve të sakta dhe të volitshme në koncentratet e ushqimit të kafshëve.

2. Të pakësohen në maksimumin e mundshëm përqindja e lëndëve të dyshuara dhe në veçanti e gjakut.

3. Të zëvendësohen mbetjet shtazore me përbërje proteinike, me lëndë të tjera bimore që kanë të njëjtën sasi proteinash, si p.sh. me drithëra.

4. Organet e specializuara zyrtare e kanë për detyrë t'i detyrojnë pronarët e fermave të kafshëve dhe pulave, që t'i izolojnë këto kafshë dhe shpendë, që ata kultivojnë të ushqehen tërësisht me ushqim të pastër, si p.sh. drithërat etj., para se ato të nxirren në tregun e konsumit, duke bërë analogji në këtë rast me xhelale-n para se ajo të theret.

5. Të mbështeten pronarët e fermave në përfitimimin e drithërave me çmime të ulëta, nëse këto do të përdoren si zëvendësues, dhe çmimi i tyre është i lartë dhe efekti rritës i tyre është i ngadaltë.

Në fund mund të themi se: ai që ruhet nga të dyshimtat, e ka ruajtur të pa cenuar fenë dhe nderin e tij."

## Asambleja e Juristëve Muslimanë të Amerikës

### VENDIMI I DYMBËDHJETË: PUNA NË DYQANET USHQIMORE DHE RESTORANTE

Muslimanin nuk i lejohet të punojë në dyqane dhe restorante, ku serviren ndër të tjera dhe ushqime të ndaluara fetarisht, nëse kjo punë përfshin kontakt të drejtpërdrejtë me objektet e ndaluara, si servirja e pijeve alkoolike, mishit të dërrit, ose përgatitja e tyre etj. Gjithsesi në këtë rast merret në konsideratë gjendja e domosdoshmërisë, e cila duhet të kufizohet brenda masës së saj, si dhe duhet bërë çdo përpjekje për të dalë nga kjo gjendje. Në këtë rast muslimani që ka këtë punë duhet ta urrejë me zemër atë dhe të jetë plotësisht i vendosur për t'u zhvendosur në një punë tjetër me mundësinë e parë që i jepet për këtë gjë. Ky musliman duhet të bëjë të gjitha përpjekjet serioze në çdo kohë për të gjetur një punë tjetër të lejuar. Lejohet të punohet si roje ose pastrues në këto dyqane ose restorante, nëse kjo punë nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me këto sende të ndaluara, si shitja, transporti, përgatitja apo servirja e tyre. Nuk është e pëlqyeshme për muslimanin të punojë si larës i gotave dhe pjatave, që përdoren për servirjen e ushqimeve të ndaluara, sepse kjo është një

ndihmesë jo e drejtpërdrejtë në drejtim të këtij gjynahu.

### VENDIMI I TREMBËDHJETË: RRETH PUNËS NË DISA VEPRIMTARI TREGTARE

1. Hapja e filialeve të dyqaneve që shesin ushqime që përmbajnë edhe haramet.

- Nuk lejohet për muslimanin të kërkoj hapjen e një filiali tregtar, për shitjen e mallrave ushqimore që përmbajnë ushqime ose pije të ndaluara fetarisht, vetëm në rast se ai si filial kufizohet në shitjen e ushqimeve të lejuara.

- Nëse kompanitë që japin të drejtën e të qenit filial i tyre nuk pranojnë të japin të drejtën për shitjen e vetëm disa prej mallrave të tyre, por në këtë rast është e mundur që këto prodhime të ndaluara fetarisht t'i marrë përsipër një ortak jomusliman, i cili nuk i konsideron ato si të ndaluara, ne nuk shohim ndonjë ndalesë në këtë drejtim, por me kusht që vetëm ortakut jomusliman t'i takojë pasuria dhe administrimi i këtij lloji malli, po ashtu edhe fitimi dhe humbja, gjithashtu duhet të vendoset një ndarje fizike e dukshme ndërmjet këtyre dy lloj mallrash, për të shmangur kështu konfuzionin dhe konfliktin.

- Nëse dikush bëhet pjesë e një kontrate tregtie për të qenë filial i një kompanie, e cila shumicën e mallrave i ka hallall, por që shet edhe ushqime dhe pije të ndaluara fetarisht jemi të mendimit, se kontrata për të qenë filial mund të vazhdohet nëse respektohen këto kritere:

1. Aktiviteti i këtij filiali nuk duhet të përfshihet në tregtimin e pijeve alkoolike, goftë kjo edhe në sasi të vogla.

2. Të bëhen përpjekje maksimale me kompaninë pronare, që ta lirojë këtë filial nga detyrimi për të tregtuar mallra haram.

3. Të pakësojë sa të jetë e mundur tregtimin dhe promovimin e mallrave haram.

4. Të jenë jomusliman ata që kanë kontakt dhe merren me përgatitjen e shitjen e mallit haram.

5. Të largohet nga pasuria e fituar nga shitja e mallit haram shuma përkatëse dhe të shpenzohet në çështje bamirësie.

#### 2. Bankomatet

- Lejohet dhënia e qira e vendit për vendosjen e bankomateve ATM, sepse këto aparatura në pjesën dërmuese të tyre përdoren për tërheqjen e shpejtë të parave nga numrat e llogarive personale.

- Lejohet për tregtarin që koston e mallit të shitur ndaj klientëve të tij ta marrë nëpërmjet kartave të kreditit, sepse kostoja e mallit e marrë në këtë mënyrë është e lejuar.

#### 3. Puna në dyqanet e argjendarisë

Muslimanin i lejohet, që të investojë ose punojë në dyqanet e argjendarisë, me kusht që shkëmbimi që duhet të bëhet dorë më dorë të respektohet, si dhe bizhuteritë që shiten të mos përmbajnë statuja ose simbole të feve dhe besimeve që bien ndesh me Islamin.

#### 4. Puna në dyqanet që ndodhen në stacionet e karburantit

Nuk i lejohet muslimanin, i cili ka investuar, ose punon në dyqanet që ndodhen pranë stacioneve të karburantit, ose në vende të tjera të merret me shitjen e biletave të lotarive, apo çdo lloj malli haram që shitet zakonisht nëpër këto vende. Ndërsa për sa i përket dhënies me qira të këtyre dyqaneve, që ndodhen pranë stacioneve të karburantit, personave të cilët shesin mallra që në shumicën e tyre janë të lejuara, por kanë edhe disa mallra haram, nuk mendojmë se kjo kontratë është e ndaluar fetarisht, sepse kontrata është nënshkruar për një shërbim të lejuar, ndërsa gjynahun në këtë rast për sendet haram e mbart vetëm qiramarrësi.

Bordi botues:  
Justinian Topulli  
Genc Plumbi  
Mustafa Tërnici

Redaktor përgjegjës:  
Roald A. Hysa

## LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri  
lidhjehoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

http://www.lidhjehoxhallareve.com

# Analizë / Radikalizëm Islam, apo injorancë radikale ndaj Islamit

Eseoi: Enklid PELARI

Kohët e fundit po vëmë re një fushatë intensive (nuk po e quajmë kryqëzatë) ndaj "islamizmit dhe islamizmave", por fatkeqësisht jo nga njerëz kompetent. Pra jo siç ndodh në botën perëndimore ku fjala bie njerëz të subvencionuar nga shteti, por jo vetëm, studiojnë për orientalizëm dhe pas studimeve informojnë opinionin publik për "të mirat" dhe "të këqijat" e kulturës orientale. Këta studiues njihen me emërtimin Orientalist. Ajo që bie në sy tek ta janë dy karakteristika esenciale: E para është dituria e thellë rreth kulturës orientale dhe e dyta është etika dhe gjuha e kuruar që ata përdorin kur flasin rreth kulturës orientale në përgjithësi dhe Islamit në veçanti. Për këtë gjë në perëndim nëpër medime të ndryshme bëhen debate të hapura dhe dialogë të ndryshëm për te promovuar tolerancën ndërkulturore.

Nga ana tjetër shohim se në Ballkan ata që bëjnë kompetent e fushës jo vetëm që fatkeqësisht nuk e kanë "haberin" e kulturës orientale dhe Islamit, por dhe gjuha e përdorur prej tyre nuk ndryshon nga ajo e një njeriu të pastudiuar. Pra mesazhi i vetëm që përcillet ndër rreshta është sharja dhe ofendimi i drejtpërdrejtë pa etikë dhe estetike, se për argumente as që bëhet fjalë. Meqë "analistët" që e kanë marrë tagrin dhe kompetencën për të baltosur "Orientalizmat" e kanë të vështirë të gjejnë argumente të mirëfilltë për para-gjykimin e tyre atëherë kam menduar tu vijë në ndihmë me disa teza të hedhura nga homologët e tyre në vende të tjera të globit. Disa prej këtyre tezave kanë mbërritur dhe në vendin tonë. Ajo që bie në sy në këto teza janë defektet logjike të qëllimshme ose jo, që në shkrimin akademik njihen me nocionin "tatëpjetë e rëshqitshme". Unë po mjaftohem me përmendjen e më të spikaturave prej tyre:

**1- XHIHADI SI NOCION TERRORIST I ISLAMIT.** Është e vërtetë që xhihadi (apo lufta e shenjtë) evidentohet në Kuran, por nuk duhet të harrojmë, se Kurani është një kushtetutë, ku si çdo kushtetutë tjetër në botë evidentohet edhe lufta, ndër të tjera edhe si "mburojë" e sigurisë kombëtare. Përndryshe në suren Teube thuhet; "Paqja është më e mirë -se lufta-".

**2- ISLAMI SI SIMOTËR E DIKTATURES.** Trendi i analistëve në botë është ta paraqesin Islamit si një fe "reaktionare" ndaj demokracisë. Faktikisht ata që merren me hulumtimin e religjioneve e dinë shumë mirë, se kjo fe përkon më shumë se çdo fe tjetër me

## Këshillat e një të urti

Shejh Ibn Bazi -rahmet pastë- duke vendosur piketat në rrugën e thirrjes islame që duhet të ndjekin thirrësit muslimanë në këtë kohë ka thënë: "Kjo kohë është koha e butësisë, durimit dhe urtësisë, nuk është koha e ashpërsisë. Shumica e njerëzve janë të paditur, të pavëmendshëm dhe të ndikuar nga kjo botë, ndaj duhet patjetër durim, duhet patjetër butësi, derisa të mbërrijë thirrja islame, derisa t'u komunikohet njerëzve, derisa të mësojnë. Lusim Allahun për të gjithë që t'i udhëzojë. AMIN.

Mexhmu el-Fetaua li Ibni Baz v. 8 fq. 376 dhe v. 10 fq. 91

parimet demokratike si; "Zgjedhjet, Kolegjialiteti dhe delegimi i kompetencave në vendimmarrje, e drejta pronë private, e drejta e sipërmarrjes, liria e tregut dhe ndershmëria e tij, lufta ndaj monopolit etj". Prandaj dhe e përditshmja prestigjioze "New York Times" pas fillimit të pranverës arabe e hapte gazetën me artikullin: "Partitë islame që po e kuptojnë demokracinë më mirë se partitë demokratike".

**3- ISLAMI SI FE E DHUNES.** Islami si çdo fe tjetër në botë është edhe një sistem moral dhe kod etik që përkthehet dhe subjektivizohet tek çdo individ në bazë të temperamentit, formimit apo kulturës së tij. Në këtë kontekst çdo musliman quhet i mangët apo i plotë në bazë të zbatimit të fesë dhe nuk mund të emërtohet "mangësia apo ekstremizmi tij" si përfaqësues i Islamit.

**4- ISLAMI SI FENOMEN DHE JO POLITIKËBËRJE.** Përhapja e Islamit në botë është një fenomen që lind natyrisht dhe jo një lëvizje politike e nxitur nga subvencionime apo investime të dyshimta shtetërore, celulash terroriste apo ideologjish ekstremiste. Që në kohën e administratës "Nano" kur u implementua për herë të parë operacioni "Fshesa" ndaj organizatave islamike arabe shohim se performanca e Islamit në vend është rritur jo vetëm në dimensionin sasi, por edhe atë cilësor.

**5- ISLAMI SI "FE" E TË MARGJINALIZUARVE.** Nuk është e vërtetë që Islami gjen implementim vetëm te shtresat më të margjinalizuara sociale. Sot kemi praktikues të kësaj feje duke filluar nga zyrtarët më të lartë, tek akademikë, pedagogë, doktorantë, e deri tek specialistë të fushave të ndryshme si mjekësi, ekonomi, inxhinieri dhe shumë e shumë fusha

të tjera, që kontribuojnë si pjesë integrale dhe e pandashme e organizimit tonë kolektiv.

**6- TENTATIVA E KAMUFLIMIT.** Sot po tentohet që Islamit t'i jepet identiteti i një feje të karakterizuar nga injoranca, varfëria apo inferioriteti. Kjo shihet qartë tek disa media kur për evenimente fetare mjaftohen me intervistimin e disa njerëzve të moshuar, që nuk do të ishte habi që përveç intelektit të kenë humbur edhe memorien. Kjo situatë do të ishte analoge sikur media në tentativë për t'i prezantuar opinionit publik një subjekt politik si "PD, PS, LSI etj" të merrte në intervistë një misërpjekës, këpuçëllustrues apo bananeshitës. Pra t'i jepte ngjyrim gjithë subjektit politik me një pjesë tepër minoritare të saj dhe jo adekuate për një prezantim dinjitoz.

**7- TERRORIZMI SI QEVERI E LEGALIZUAR.** Nëse do të ishte e vërtetë teza se muslimanët janë radikalë, xhihadistë, që propagandojnë vetëm luftën e shenjtë, atëherë qytetarët do të ngrenin një pyetje ndaj jush: "Pse kur parti islame në botë qeverisin vende të fuqishme si Turqia, Egjipti, etj., nuk i shpallin "xhihad" botës perëndimore? Madje kanë marrëdhënie diplomatike edhe me armiq të tyre tradicional si Izraeli! A mos ndoshta dhe Islami është një fe që e pranon edhe luftën, edhe paqen, edhe marrëveshjen, edhe diplomacinë si rend qeverisje apo politikëbërje në botë?"

**8- ISLAMI SI ROJE MORALE.** Shoqëria shqiptare ka një "hemorragji" të theksuar në ruajtjen e moralit të rinisë nga virtutet dhe veset e këqija si droga, bixhozi, imoraliteti, krimi etj. Shumë njerëz të rinj në mungesë të alternativës gjejnë prehje në religjionet që operojnë në vend. Nëse kjo xhelozon këdo në shoqëri, atëherë le të

vijë me platforma më atraktive dhe të integruara në mënyrë që të plotësojmë ato vakuume, që nuk i kemi plotësuar deri më sot si shoqëri.

**9- ISLAMI SI EKSTERNALITET POZITIV.** Ekzistenca e fesë në shoqëri sjell për të benefite të dobishme jashtë mekanizmave të tregut. Një njeri fetar ka prirje më të dobëta dhe probabilitet më të ulët për të vjedhur, spekuluar, mashtruar, gënjyer etj. Kjo bën që shoqëria të përfitojë prej këtyre sjelljeve të ekuilibruara, të cilat në periudhë afatgjatë sjellin stabilitet në mekanizmat socio-ekonomik të vendit.

Mesa shohim pra Islami është një pjesë e pandashme e shoqërisë globale. Ai operon normalisht si çdo lëvizje, organizim, religjion apo ideologji e legalizuar dhe e pranuar gjerësisht në botë. Ekstremizmat dhe radikalizmat ekzistojnë në çdo fe dhe në çdo ideologji. Madje dhe në sistemet demokratike ka parti të djathta apo të majta ekstremiste, që propagandojnë dhe nxisin për luftë. Mos të shkojmë më larg se e majta ekstreme e fqinjëve tanë grekë, apo e djathta ekstreme në Itali. Ajo që e përfaqëson një organizim kolektiv është performanca afatgjatë dhe jo devianca e individëve të caktuar apo rastet e izoluar sporadike. Prandaj Islami nuk ka qenë dhe nuk do të jetë një kërcënim apo rrezik kombëtar. Nuk duhet harruar se që nga Lidhja e Prizrenit, tek Fetvaja Vehbi Dibres, e deri tek themelimi UÇK-së, ata kanë qenë një nga faktorët më determinues për sjelljen e pavarësisë në viset tona dhe për asnjë arsye apo motiv nuk do të konvertoheshin në një kundraindikim për interesat kombëtare.

Sot muslimanët i kanë të gjithë potencialët akademikë, administrativ, financiarë, kanë madje dhe kuorumin e nevojshëm për të themeluar një parti që do të ishte faktor në politikëbërjen e vendit. Këtë gjë nëse nuk e dinë analistët e dinë shumë mirë politikanët që mundohen t'i përcjellin ata me muhabete kafenesh dhe ndërtime xhamish. Fakti që sot muslimanët shqiptarë nuk kanë ambicie dhe nuk tentojnë për të themeluar parti është argumenti më i fortë se ata ndjehen të përfaqësuar nga partitë politike që bëjnë ligjet dhe qeverisin në vend. Pra janë liridashës dhe konvenient me të. Në doktrinën historike ka një parim të induktuar; "Cilësi e lëvizjeve ekstremiste është dritëshkurtësia dhe nxitimi në vendimet politike, çka gjithmonë i çon këto lëvizje në dështim dhe sjellje radikale". \*

\* Idetë e shprehura në këtë artikull janë personale të autorit dhe nuk shprehin qëndrimin e ndonjë institucioni.

## Oazi i Shpirtit / Surja Fatiha dhe lumturia e njeriut

Nga Ibn Kajim el-XHEUZIJE



Njeriu ka dy mundësi: njëren që ka të bëjë me dijen teorike dhe tjetrën që është praktikimi i vullnetshëm. Lumturia e njeriut qëndron pikërisht në plotësimin dhe përsosmërinë e këtyre dy mundësive, dijen dhe praktikën.

Mundësia e dijes përsoset duke njohur Krijuesin, Zotin e gjithësisë, emrat dhe cilësitë e Tij, rrugën që të çon për tek Ai, shkarjet që të largojnë prej Tij. Po ashtu njeriu duhet të njohë vetveten me dobësitë dhe gabimet që ka. Me anë të këtyre pesë njohurive arrihet përsosmëria e mundësisë së dijes dhe njerëziteti më të ditur

janë ata, që i njohin më së miri këto gjëra dhe i kuptojnë ato.

Mundësia e praktikës dhe e vullnetit mund të përsoset vetëm duke vënë në jetë detyrimet, që njeriu ka ndaj Zotit, me vërtetësi, sinqeritet, përkushtim, ndrojtje dhe duke pranuar se nuk ia ka dhënë Krijuesit të tij hakun që i takon dhe e meriton. Njeriu duhet ta pranojë, se nuk mundet t'i përsosë këto dy mundësi përveçse me ndihmën e Allahut. Ai ka nevojë së tepërmi, që të udhëzohet në udhën e drejtë, në udhën që ecën eulijatë dhe njerëzit e Zotit. Njeriu ka nevojë për ndihmën e Allahut, që të mos shkasë nga udha e drejtë me shkatërrimin e mundësisë së dijes dhe për rrjedhim rënien në humbje; apo me shkatërrimin e mundësisë praktike dhe për rrjedhim rënien në zemërimin e Allahut. Përsosmëria e njeriut dhe lumturia e tij plotësohet vetëm duke mbledhur të gjitha këto aspekte, të cilat janë përshkruar mjaft bukur në suren Fatiha:

Fjala e Allahut: "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve. I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. I Vetmi Mbisundues i Ditës së Shpërblimit (Ditës së Ringjalljes)". (Fatiha, 1-3), përmban elementin e pare, që është njohja e Zotit, emrave, cilësive dhe veprimeve të Tij. Emrat e Allahut të

përmendur në këtë sure përbëjnë bazën e emrave të bukur të Allahut, e ata janë: Allah, Zot dhe i Gjithëmëshirshëm.

Emri "Allah" tregon cilësitë hyjnore të Zotit dhe adhurimin që duhet t'i kushtojnë krijesat Atij.

Emri "Zot" tregon cilësitë që kanë të bëjnë me Plotfuqishmërinë dhe zotërimin Absolut të Tij.

Emri "i Gjithëmëshirshëm" tregon cilësitë e Mirësisë dhe Bujarisë së Zotit.

Kuptimet e të gjithë emrave të Allahut përsillen rreth këtyre tre emrave.

Fjala e Allahut: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë" (Fatiha, 4), tregon njohjen e rrugës, që të shpie për tek Allahu, e cila nuk është gjë tjetër veçse adhurimi i vetëm i Tij, ashtu siç dëshiron Ai dhe është i kënaqur, dhe kjo arrihet me ndihmën dhe përkrahjen e Tij.

Fjala e Allahut: "Përforcona (drejtona) në Rrugën e Drejtë." (Fatiha, 5), tregon se njeriu mund ta arrijë lumturinë vetëm duke iu përmbajtur rrugës së drejtë dhe ai mund t'i përmbahet kësaj gjëje vetëm me anë të udhëzimit, që i jep Zoti i tij, ashtu siç nuk e kryen dot adhurimin vetëm se me ndihmën e Tij, prandaj gjithçka varet nga udhëzimi i Allahut.

Fjala e Allahut: "Jo në (rugë) të atyre që e

merituan Zemërimin Tënd mbi vete dhe as në (rugë) të atyre, të cilët e humbën veten." (Fatiha, 7), tregon dy llojet e shmangjeve nga rruga e drejtë. Njëra shmangje shpie në humbje dhe vjen si rezultat i padijes dhe besimit të gabuar, ndërsa shmangja tjetër shpie në zemërimin e Allahut dhe vjen si pasojë e qëllimit të keq dhe punës së padobishme.

Fillimi i sures Fatiha trajton Mëshirën e Allahut, mesazhi i saj Udhëzimin, dhe fundi Mirësinë e Tij.

Njeriu do të përfitojë nga kjo mirësi për aq sa ai është i udhëzuar, dhe ai është i udhëzuar për aq sa është mëshiruar nga Allahu. Pra, e gjithë çështja përsillet rreth Mirësisë dhe Mëshirës së Allahut. Mëshira dhe Mirësia janë attribute, që vijnë si rrjedhojë e Plotfuqishmërisë dhe Zotërimin Absolut të Allahut. Ai nuk mund të jetë ndryshe vetëm se i Mëshirshëm dhe Mirëbërës, cilësi këto që rrjedhin nga Hyjnia e Tij; Ai është i Adhuruari i Vërtetë, edhe nëse nuk e pranojnë ateistët Atë, apo i bëjnë ortak politeistët.

Kushdo që kupton dhe vë në jetë përmbajtjen dhe kuptimet e sures Fatiha do të arrijë përsosmërinë më të madhe dhe adhurimi i tij ndaj Allahut do të arrijë gradën e njerëzve të veçantë, të cilët qëndrojnë shumë më lart se sa adhuruesit e thjeshtë. Allahu na ardhë në ndihmë!

## Ekonomi

## Kontrata e mirëmbajtjes dhe e riparimit

Përgatiti: Llokman HOXHA

Industria ka përparuar shumë kohëve të fundit, gjë që ka sjellë edhe mjete industriale të shumta dhe të llojllojshme. Duke qenë se ato mund të dëmtohen dhe ngecin, gjë e cila ndikon negativisht në produktivitetin e tyre është paraparë kujdesi ndaj tyre, që të jenë efektive për një kohë sa më të gjatë. Për këtë është parë e domosdoshme, që pronarët e këtyre gjësedeve të gjejnë ekspertë dhe teknikë të ndryshëm, të cilët do të kujdesen për to, t'i mirëmbajnë ato dhe të bëjnë riparimin e tyre, gjë e cila shkaktoi që të shpiket edhe kontrata e mirëmbajtjes dhe e riparimit, si një gjë shumë e rëndësishme dhe e nevojshme në shumë sfera jetësore. Kontrata e riparimit konsiderohet si një kontratë relativisht e re në Legjislacionin Islam, duke qenë se nuk është e shtjelluar dhe e trajtuar në librat e fikhut, si një kontratë e veçantë siç është sot, por siç është e njohur se çdo gjë që shpiket, parjetër se duhet të ketë dispozitën e vet fetare, baza e së cilës duhet gjetur qoftë në librat e hershëm të dijetarëve, ose me anë të përpjekjes së dijetarëve bashkëkohorë për të gjetur një vendim, i cili nuk bie ndesh me parimet islame.

## Ç'është kontrata e mirëmbajtjes dhe e riparimit?

Është një marrëveshje me një kontratë të veçantë, ose në kuadër të një kontrate të caktuar, e cila bëhet në mes të kompanisë ose ekspertit dhe pronarit të gjësedit (mjet, kompjuter, celular, makinë etj.), për mirëmbajtjen dhe riparimin e gjësedit në fjalë, gjatë një kohe të caktuar, me qëllim që të ruajë efikasitetin e tij, në këmbim të një shume të caktuar.

## Legjitimiteti i kontratës së mirëmbajtjes dhe riparimit.

Megjithëse thamë se është një kontratë e re në fikhun islam, ajo i plotëson kriteret, që duhet t'i përmbushë një kontratë sipas parimeve islame, gjë e cila i jep legjitimitetin e saj fillimisht. Duke u bazuar në atë se rregullat dhe parimet islame e konsiderojnë, se çdo gjë e cila ka të bëjë me çështjet jetësore në esencë është e lejuar, për derisa nuk bie ndesh me ndonjë dispozitë fetare të caktuar, dhe këtë e dëshmon:

1- Fjala e Allahu të Lartësuar: "Ai është që për ju, ka krijuar gjithë atë që është në tokë". (Bekare: 29)

2- Si dhe fjala e të Dërguarit të Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të): "Muslimanët duhet t'i përmbahen kushteve që vendosin mes vete." (Ebu Davudi, Tirmidhiu, -Albani e konsideroi sahih). Pra, kjo kontratë si tërësi është e lejuar, por gjithsesi duke i plotësuar kushtet përkatëse, të cilat i kanë sqaruar dijetarët islamë, përndryshe si të gjitha kontrata e tjera, të cilat mund të jenë të lejuara, por për shkak të mosplotësimin të kriterëve fetare, ajo bëhet e ndaluar.

Kontrata e mirëmbajtjes përfshin:

1. Mirëmbajtjen, që nënkupton kontrollin periodik të gjësedit të caktuar, për t'u siguruar në efikasitetin e tij, si dhe për të zbuluar defektet e paraqitura dhe pjesët përkatëse, të cilat duhet riparuar ose ndërruar. Qëllimi i kësaj kontrate është shmangia e defekteve të mundshme, me qëllim kursimin e shpenzimeve për riparimin e tij në rast të prishjes.

2. Riparimin, që nënkupton rregullimin (ujdisjen) e gjësedit pas prishjes së tij.

Qëllimi i kësaj kontrate është zgjatja e

jetës së tij sa më shumë që të jetë e mundshme, derisa të bëhet plotësisht e paaftë për ta zëvendësuar pastaj me ndonjë gjësedit tjetër.

3. Mirëmbajtjen dhe riparimin tok, shumica e kontratave janë të këtij lloji, dhe kur përmendet sot në qarqet komerciale si kontratë nënkupton që të dy shërbimet.

Mirëmbajtja e plotë realizon qëllimin e dy llojeve paraprake. Ekzistojnë disa forma të kësaj kontrate varësisht nga gjësediti për të cilin bëhet kontrata, por në korniza të përgjithshme po përmendim më kryesoret pastaj do të sqarojmë cilat janë të lejuara e cilat jo:

**Forma e parë:** Kontratë e mirëmbajtjes e veçantë: që nënkupton kontratën, e cila bëhet në mes pronarit të gjësedit dhe ndonjë kompanie të caktuar për mirëmbajtjen e tij për një kohë të caktuar në këmbim të një shume të caktuar.

Kjo bëhet në tri mënyra:

a. Kontrata vetëm për mirëmbajtje d.m.th. vetëm punëdore, pa mjete, që nënkupton p.sh. ndërrimin e vajit në kohë të caktuara, pastrimin e mjeteve etj. Në këtë rast i kontraktuari mund të jetë punëtor i rregullt vetëm tek pronari, por mund të jetë privat që punon edhe për të tjerët.

b. Kontrata vetëm për punëdore, kurse mjetet (p.sh., vajin, mjetet e pastrimit, veglat e punës) përkatëse i sjell pronari.

c. Kontrata për punëdore dhe mjetet përkatëse për mirëmbajtje (p.sh., vegla të thjeshta të domosdoshme për çdo punëtor, të cilat nuk llogariten zakonisht në çmim) i sjell i kontraktuari.

Kjo formë në të tri mënyrat është e lejuar, me kusht që të dihet saktë puna që do të kryejë, koha e punës dhe mëditja ose rroga.

**Forma e dytë:** Kontratë e mirëmbajtjes në kuadër të shitjes së gjësedit, që nënkupton: blerjen e një mjeti, makine etj., duke e kushtëzuar mirëmbajtjen për një çmim shtesë, por në të njëjtën kontratë të shitblerjes, pra negociohet për çmimin e mallit pastaj negociohet për çmimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe në fund mblihdet çmimi i përgjithshëm në të njëjtën kontratë.

**Forma e tretë:** Kontratë e mirëmbajtjes në kuadër të shitjes së gjësedit, që nënkupton: blerjen e një mjeti, makine etj., duke e kushtëzuar mirëmbajtjen në çmimin e shitblerjes, duke mos e rritur çmimin e mallit, për shkak të shërbimit shtesë, qoftë ky kusht nga blerësi apo shërbim nga vetë shitësi. Forma e dytë dhe e tretë gjithashtu është e lejuar, meqë nuk kanë dallim në mes



vete përveç mënyrës së caktimit të çmimit. Duke pasur parasysh gjithmonë që puna të jetë e caktuar mirë dhe çmimi të jetë i saktë, që të mos çojë në konflikt.

**Forma e katërt:** Kontratë e riparimit e veçantë, që nënkupton: kontratën në mes pronarit të gjësedit me ndonjë kompani të caktuar për të riparuar mjetin në rast të paraqitjes së defekteve në këmbim të një shume të caktuar përgjatë një kohe të caktuar. Pra, kontrata është për të ndërhyrë vetëm në raste emergjence dhe e pavarur nga kontrata e shitblerjes së gjësedit. Dispozita për këtë formë varet nga mënyra se si aplikohet kjo kontratë:

a. Nëse pjesët e riparimit i sjell pronari i gjësedit, apo ia paguan atij që i sjell me çmimin përkatës, ndërsa i kontraktuari kryen vetëm punën. Kjo mënyrë është e lejuar.

b. Nëse pjesët e riparimit i sjell i kontraktuari dhe pjesët zakonisht janë të papërcaktuara dhe kanë çmime të ndryshme, qoftë kontrata për mirëmbajtje (riparim) periodike apo për riparim emergjent.

Kjo formë është e ndaluar sepse i përngjan sigurimit komercial, i cili është i ndaluar, ngase pagesa bëhet përballë rrezikut, i cili mund të ndodhë, por mund të mos ndodhë. Nëse ndodh prishja, atëherë pagesa mujore ose vjetore mund të jetë shumë e ulët, kështu që i shkakton humbje të kontraktuarit, nëse nuk ka prishje fare, të hollat e pronarit shkojnë kot. Për këtë është e ndaluar.

**Forma e pestë:** Kontrata e mirëmbajtjes në rastin e qirasë, kush duhet të mbajë përgjegjësinë e mirëmbajtjes së objektit, qiradhënësi apo qiramarrësi? Nëse

mirëmbajtja (riparimi) është nga lloji prej së cilës varet mundësia e shfrytëzimit të gjësedit të marrur me qira, atëherë kjo i detyrohet qiradhënësit, si p.sh., nëse muret janë të shtrembëruara në shtëpinë me qira duhet t'i drejttojë pronari, nëse vetura ka defekte në makinë pa fajin e qiramarrësit këtë duhet ta rregullojë pronari, sepse këto janë gjëra pa të cilat nuk mund të shfrytëzohet objekti për qira, dhe nuk lejohet të ngarkohet me të qiramarrësi.

Ndërsa mirëmbajtja ngaqë është nga lloji i cili nuk varet nga ai mundësia e shfrytëzimit, si ljerja e mureve të shtëpisë, ndërrimi i vajit të makinës, materiale harxhuese etj., gjëra të cilat nuk pengojnë mundësinë e shfrytëzimit të objektit për qira, lejohet t'i kushtëzohet qiramarrësit po edhe qiradhënësit, sipas marrëveshjes, me kusht që të jetë çdo gjë e përcaktuar mirë dhe qartë. Pra nuk i takon qiradhënësit të përkujdeset për mirëmbajtjen operative, përveç nëse kjo shënohet në kontratë, po ashtu nuk lejohet të ngarkohet qiramarrësi me riparimet kapitale, përveç nëse ai është shkaktar direkt dhe i qëllimshëm i dëmit përkatës.

**Forma e gjashtë:** Kontrata e mirëmbajtjes e shoqëruar në kontratën e sipërmarrjes. A lejohet t'i kushtëzohet sipërmarrjes mirëmbajtja e gjësedit të prodhuar, si p.sh. një sipërmarrje të marrë me kontratë ndërtimin e një objekti dhe mirëmbajtjen e tij, apo një makine dhe mirëmbajtjen e saj, për një kohë të caktuar me një çmim të caktuar, kjo formë është e lejuar, ngase mirëmbajtja është kusht dhe çmimi i kontratës bazë e përfshin edhe atë.

## Stamboll - panairi i ushqimeve hallall hapet në 11 tetor



Panairi i Prodhimeve Hallall dhe të Shëndetshme do të zhvillohet në Stamboll, në datat 11-14 tetor 2012 në të njëjtën kohë me Panairin e 14-të të MÜSIAD-it dhe Kongresit të 16-të të Forumit Ndërkombëtar të Biznesit (IBF). Madhësia e tregut botëror të prodhimeve hallall ka arritur në 2,1 trilionë dollarë. Firmat turke duan të marrin një pjesë më të madhe nga ky treg kaq i madh, 15 herë sa eksporti total i Turqisë. Kompanitë turke do të takohen në Panairin Ndërkombëtar të Ushqimeve Hallall dhe të Shëndetshme, që do të organizohet në qendrën e panaireve CNR Expo në Stamboll në datat 11-14 tetor. Organizimi në të njëjtën kohë i dy

aktiviteteve me përmasa të mëdha do t'i sjellë një sinergji të madhe këtij sektori.

Firmat turke, të cilat synojnë një pjesë më të madhe nga torta e këtij tregu gjigand, që zmadhohet çdo vit e më shumë, blerësit që do të vijnë nga jashtë shtetit, drejtuesit e marketeve dhe supermarketeve të njohura, shitësit me shumicë, shpërndarësit, shitësit me pakicë, furnitorët, prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit në javën e dytë të tetorit do të takohen në Stamboll nën çatinë e qendrës së panaireve CNR Expo.

Panairi organizohet me kontributin e kompanisë, Sine Fuarçılık Organizasyonu, një firmë pjesë e holdingut CNR, Shoqata e Mbikëqyrjes dhe Çertifikimit

të Ushqimeve dhe Lëndëve të Nevojshme (GİMDES), Këshilli Botëror i Prodhimeve Hallall (WHC) si dhe KOSGEB.

Në panair do të ekspozohen prodhimeve hallall të sektorëve të ndryshëm si ushqim, pije freskuese, kozmetikë, produkte medikale, pastrim, higjienë, moda islame, tekstil, veshje për mbulimin e kokës dhe trupit, materiale të nevojshme për të realizuar pelegrinazhin në Mekë etj. Pritet që panairi të vizitohet nga një numër i madh profesionistësh, që do të vijnë nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Malajzia, Indonezia, Filipinet, Singapori, SHBA, Arabia Saudite, Gjermania, Holanda, Franca, Algjeria, Maroku, Kanadaja dhe Japonia.

# Të ashtuquajturat mrekuilli...

Nga Justinian TOPULLI

Na ka bërë shpesh vaki të dëgjojmë për disa ngjarje apo të shohim shfaqje e foto të cilat qarkullojnë në mesin e besimtarëve si mrekuilli të Zotit, si p.sh, një luan i futur në kafaz që dukej sikur thoshte Allah me ulërimën e tij, pllaja mali, kokrra vezësh, degë dhe trungje pemësh, perime e fruta të prerë në gjysmë apo larat e kafshëve të ndryshme, që dukeshin sikur paraqitnin emrin Allah në arabisht apo Muhamed...etj...etj.

Para se flasë për temën që mban titulli i këtij shkrimi, më duhet detyrimisht, për të mos keqkuptuar atë që do të them më pas, të bëjë disa pohime që kanë të bëjnë me bazat e besimit tonë e të cilat as unë dhe as një mysliman tjetër nuk duhet t'i vërë në dyshim.

Së pari, çdo besimtarë në Zot duhet të besoj dhe të jetë i bindur plotësisht se Zoti është i Plotfuqishëm dhe se Ai bën çfarë të dojë dhe si të dojë dhe kur të dojë, asgjë nuk është e pamundur për Të, dhe pikërisht për të rënjosur këtë besim Allah e përsërit këtë gjë në Kuran në mbi njëzet sure në më shumë se tridhjetë ajete, ku Ai thotë shkoqur dhe qartë: "Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë".

Së dyti, e gjithë bota që ne shohim dhe ajo që nuk shohim është krijesë e Zotit dhe si e tillë ajo i nënshtrohet ligjeve të Tij, ndaj asgjë që ndodh në këtë botë nuk del jashtë ligjeve të Tij, edhe pse mund të ketë gjëra të cilat janë të panjohura apo të pashpjegueshme për njerëzit, të cilat dalin jashtë njohurive të kufizuara njerëzore, ato në thelb nuk dalin jashtë të gjitha ligjeve që Zoti ka vendosur. Kjo natyrisht që ka lidhje me besimin se gjërat në këtë botë ndodhin në bazë të ligjit të shkak-pasojës dhe se asgjë nuk del jashtë këtij ligji të Zotit. Kjo është akidja e shumicës së myslimanëve, e chli suneh uel xhemah, në dallim me disa sekte kelamiste që besojnë ndryshe.

Veç kësaj këtu nuk mund të lë pa përmendur faktin, që për fat të keq shumë prej besimtarëve nuk e dinë, se që një ndodhi të quhet mrekuilli, ajo duhet të jetë tepër e qartë dhe sfiduese, e tillë që të mos ketë mundësi të hidhet poshtë apo vihet në dyshim për shkak të paqartësisë së saj. Kështu pra tendenca që shohim sot tek disa myslimanë për të zbuluar emrin e Allahut apo të Profetit nëpër konfigurime që formohen nga vija të ndryshme në formë damarësh nëpër objekte të ndryshme është tepër mjerane, sepse të tilla "shkrime" shpesh herë nuk janë qartësisht të lexueshme dhe shumëkush nëse i sheh i pa motivuar dhe i painformuar më parë, nuk do tu bënte asgjë përshtypje për t'i tërhequr vëmendjen, mirëpo pasi dikush "e sheh të veçantën" e saj dhe ua tregon të tjerëve si të tillë, atëherë në këtë rast leximi dhe vëmendja apo vështrimi i saj bëhet subjektiv nga të tjerët, duke mos marrë parasysh pjesën tjetër të konfigurimit, por duke u fokusuar në mënyrë të njëanshme vetëm tek pjesa e "mrekullisë". Pra kjo në fakt nuk është vetëm se një vetëmshkrim, për shkak të një efekti psikologjik që ndodh për shkak të motivimit për të parë një mrekuilli. Kështu që mrekuilla duhet të jetë patjetër e qartë e të japë një mesazh të qartë e të lexueshëm për të gjithë ata që e shohin, pa pasur nevojën e një procesi motivimi të tillë, aq sa vetëm nga një njeri mohues, i verbër në shpirt e kryeneç mund të mohohet. Duke u nisur nga kjo që thamë shfaqje të tilla jo që nuk janë mrekuilli, por është turp dhe mungesë serioziteti të trumbetohen si të tilla.

Së treti, Allahu e ka shfaqur Vetën e Tij për ne si krijesa nëpërmjet shenjave apo argumenteve të Tij, këto shenja janë ekzistenciale/kozologjike dhe fetare. Të parat janë gjithçka që ne shohim, qielli dhe toka, njerëzit, kafshët dhe bimët, ujërat, detet, oqeanet, liqenet, lumenjtë, shiu, yjet dhe planetët, dielli, hëna, jupiteri, marsi etj... etj... Allahu thotë në Kuran: "Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t'u sjellë dobi njerëzve, në ujën që zbret Allahu prej qiellit, duke ngjallur përmes tij

tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt." (el-Bekare: 164)

Së katërti, Kurani mbetet mrekuilla më e madhe që Allahu i dhuroi Profetit Muhamed (alejhi salatu ue selam). Natyrisht që ne besojmë edhe në mrekuillitë e tjera që Allahu i dhuroi Profetit tonë gjatë jetës së tij, ato të cilat provohen se janë autentike, si p.sh, vajtimi i trungut të palmës mbi të cilin Profeti (alejhi salatu ue selam) mbante hutbet, shumëfishimi i ushqimit të pakët apo ujit, etj, por gjithsesi mrekuilla më e madhe e tij e asaj kohe dhe e sotme ngelet Kurani, ndaj dhe Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Çdo Profeti i janë dhënë argumente të atilla saqë prej tyre do të besonte mbarë njerëzimi. Por, mua më është dhënë zbulesa hyjnore (uahji) të cilën Allahu ma shpalli, ndaj shpresoj që të jem Profeti që do të ketë më shumë ndjekës Ditën e Kiametit." (Buhari & Muslimi)

Këto fjalë të Profetit (alejhi salatu ue selam) tregojnë qartë se nga do të vijë argumentet më të rëndësime dhe më të forta që do t'i bëjnë njerëzit të besojnë tek Zoti dhe në këtë fe.

Përkundrazi! Ata njerëz që kërkojnë argumente dhe mrekuilli të tjera, në fakt duket se çojnë ujë në mullin e jobesimtarëve të mëparshëm, që kërkonin nga Profetët e tyre mrekuilli të një natyre krejt tjetër për të besuar, siç i kërkuan këtë edhe nga Profeti ynë "Ata thonë: "Ne nuk do të të besojmë (o Muhamed), derisa të bësh, që të shpërthejë nga toka një gurrë uji për ne, ose, derisa të kesh një kopsht hurmash dhe rrushi, nëpër të cilin të rrjedhin lumenj ose, derisa ta bësh qiellin të bjerë copa mbi ne, siç ke thënë ose, derisa të sjellësh Allahun dhe engjëjt para nesh; ose, derisa të kesh shtëpi prej ari ose, derisa të ngitesh në qiell. Ne nuk do të të besojmë, edhe sikur të ngitesh në qiell, derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë". Thuaj: "I Përlëvduar qoftë Zoti im! Unë nuk jam tjetër, veçse njeri - i dërguar!" (El-Isra: 90-93)

"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarë, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë): "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit." (Al-imran: 190-191)

Kështu pra mrekuillitë e Zotit janë kaq të gjalla, madhështore dhe të pranishme mes nesh, sa që të kërkojnë mrekuilli të tjera për të provuar besimin në Zot apo vërtetësinë e Islamit tek konfigurime damarësh e vijash që formohen në një domate të kalbur, që pas prerjes u duka se qenka shkruar në të Allah në arabisht, apo tek vija të ngjashme nëpër male e kodra, e nëpër kafshë të ndryshme, nuk tregon në fakt vetëm se krizë besimi që i ka kapluar njerëzit, krizë intelektit dhe meditimi, që edhe pse besojnë në Zot shkojnë e u bien pas çikërrimave të tilla, shpesh edhe banale e abuzive, tamam si ai që kërkon të gjejë rrugën në mes të ditës me diell, nga drita e fishkur e një qiri të largët!

Kështu pra, fakti që edhe një pjesë e besimtarëve bien në një nivel të tillë ngjashmërie me jobesimtarët e dikurshëm, tregon se çfarë krize besimi në Zot përjetojnë sot njerëzit. Në fakt këta njerëz veç mangësisë së dijes në njohjen e fesë dhe nivelit të mjeruar të arsytimit e të qasjes ndaj këtyre fenomeneve, dëmin më të madh ia bëjnë besimit dhe fesë së tyre me imazhin që ata japin në sytë e atyre që nuk besojnë dhe që kanë njëfarë niveli intelektual në të kuptuarit e gjërave. Këta besimtarë nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se me padijen e tyre u "provojnë" këtyre të pafeve se besimi në Zot nuk është vetëm se besëtytni të kota dhe broçkulla me okë, të denja për tu tallur me to! A ka shërbim më të keq sesa kjo që mund t'i bëj dikush besimit të tij?! E për më tepër i hapin rrugën edhe

idhujtarëve dhe gjithëfarë besimesh të kota të kenë mundësi "të provojnë" fetë e tyre me të tilla "argumente"! Pse jo?! "O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobesimtarët dhe falna ne, o Zot. Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti." (el-Mumetehine: 5)

Allahu thotë: "A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë dhe bëmë nga uji çdo gjë të gjallë! Akoma nuk besojnë?! Ne vendosëm nëpër Tokë male të patundura, që ajo të mos lëkundet bashkë me njerëzit dhe bëmë lugina dhe rrugë për të udhëtuar në to. Ne e bëmë qiellin mbulesë të mbrojtur, por përsëri ata shmangen nga shenjat që gjenden aty." (El-Enbija: 30-32)

Pra nëse ka njerëz që nuk u besojnë argumenteve madhështore të Zotit në këtë botë, atëherë mos prisni ju o myslimanë që ata tu besojnë këtyre gjërave qesharake, ndaj të cilave një besimtarë i mirë duhet të rrijë larg. Kur jobesimtarët e dikurshëm nuk u besonin as mrekuillive që sillnin Profetët e Allahut, e si atëherë do tu besojnë këtyre gjërave -që disa besimtarë na i trumbetojnë si mrekuilli të mëdha- jobesimtarët e sotëm që janë shumë herë më të sofistikuar?! A nuk e lexojnë ata në Kuran se Allahu për të tillë njerëz thotë: "Ata nuk e besojnë atë, me gjithë shembujt e popujve të kaluar." E madje Allahu thotë: "Edhe sikur Ne të hapnim një derë të qiellit dhe të ngiteshin nëpër të, ata me siguri që do të thoshin: "Sytë tanë kanë qenë të shushatur, madje na kanë magjepsur!" (el-Hixhr: 13-15) E sipër të treguar se kush janë argumentet e qarta të Zotit në këtë botë për shkak të të cilave njerëzit duhet të besojnë, Allahu në ajetet në vazhdim të sures së cituar, u rikujton edhe njëherë njerëzve se është Ai që ka krijuar qiellin dhe yjet, tokën dhe gjithçka jeton në të, njeriun dhe ujën, e se është Ai që dhuron jetën dhe e merr atë etj; atëherë si është e mundur që disa myslimanë sot nuk ndjekin shembullin që Zoti i tyre u jep në Kuran?!

Nëse do të zgjatesha, do të detyrohesha të citoja me dhjetëra ajete të tjera ku Allahu u shpalos njerëzve të tilla argumente për besimin në Të, por besoj se edhe kaq është e mjaftueshme. Fatkeqësia e jonë sot është se e nuk e lexojmë Kurandin dhe nuk i jetojmë fjalët e Zotit në të, ndryshe nuk ka sesi shpjegohet një përkushtim kaq i madh nga një pjesë e besimtarëve ndaj të tilla "argumenteve"! E për më tepër edhe kur i këshillon disa prej tyre nuk heqin dorë, por replikojnë me arsyetime pavlerë me këshilluesin, duke i hedhur ndonjëherë edhe akuzë banale dhe ironi fyese, siç mund të bëjnë edhe me këtë shkrim kur ta lexojnë.

Një problem tjetër që shfaqet në vazhdim e këtyre të ashtuquajturave mrekuilli është se shpesh ngjarje apo fenomene të tilla rezultojnë mbas verifikimit ngjarje jo-autentike apo keqkuptime banale apo për fat të keq edhe gënjeshtër të mirëfillta. Le të marrim si shembull disa prej tyre. Shumë prej nesh ka dëgjuar se njeriu i parë që zbriti në hënë ka dëgjuar ezanin muhamedan në të dhe se kur atij i ra rasti njëherë të shkonte në një vend mysliman u ndesh me të njëjtën gjë që kishte dëgjuar në hënë, e kjo u bë shkak që ai të futej në Islam.

Me gjithë përhapjen e madhe që ka ky lajm, e vetmja gjë që kam konstatuar deri më sot -nëse dikush di më tepër është i lutur të më informoj- nga dy burime të ndryshme është se, ky lajm është botuar në një gazetë maleziane. Mirëpo kurrkund nuk thuhet se nga e ka burimin ky lajm? Askush nuk citon vetë Nil Armstrongun të na tregojë këtë histori nga goja e tij, e për më tepër që sipas kësaj legjende urbane ai është bërë mysliman?! Do të ishte vërtetë diçka tepër interesante që këtë ngjarje ta dëgjonin nga goja e vetë protagonistit, mirëpo diçka e tillë deri më sot kurrë nuk e kemi dëgjuar dhe as parë!!! Në këtë rast tamam vlen ajo shprehja e urtë që thotë: Ç'më kërkon gjurmët kur ja tek e ke ujkun! Kështu që për shumë kohë për mua kjo ngjarje mbeti diçka

e pa provuar derisa para disa kohësh më bie rasti të lexoj një intervistë të shkencëtarit mysliman egjiptiano-amerikan Faruk El-Baz, një nga njerëzit kryesor të NASA-s që përgatiti dhe trajnoi ekipin që shkoi për herë të parë në Hënë. Dhe kur z. Faruk -njeriu më i afërt me Armstrongun sesa miliona myslimanë të tjerë- u pyet nga intervistuesi rreth kësaj ngjarje ai shpjegoi se nuk dinte që kjo të kishte ndodhur dhe as kurrë nuk kishte dëgjuar nga Armstrongu apo dikush tjetër që ai të kishte dëgjuar ezanin në hënë dhe se ai ishte bërë mysliman! Madje ai aludoi se ndoshta kjo gjë mund të ketë ndodhur për shkak të një keqkuptim për shkak të përhëndetjes me Es-selam Alejkum, që bëri një nga anëtarët e tjerë të ekuipazhit të anijes Apollo kur ata mbërritën në Hënë, për respekt ndaj tij. Z. Faruk tregon se astronauti në fjalë kërkoi prej tij para se të nisej se çfarë mund të bënte ai për të në shenjë respekti ndaj gjithë atij mudi që ai kishte dhënë, dhe z. Faruk i kishte kërkuar që ta përhëndeste prej andej në gjuhën e tij, pra me Es-selam alejkum. E ndoshta është pikërisht kjo fjalë arsyeja që i ka dhënë fill gjithë kësaj legjende urbane të përhapur në mes myslimanëve që nga Maroku deri në Indonezi. Kjo që thashë është lehtësisht e verifikueshme nëse kërkoni në internet. Imagjoni tani se çfarë imazhi të shëmtuar dhe gënjeshtër përhapin myslimanët duke përcjellë gojë mbas goje këtë të pavërtetë. "Mjafton për një njeri që të thuhet se gënjen, nëse flet me çdo gjë që dëgjon." -thotë Profeti (alejhi salatu ue selam)- (trs. Muslimi).

Le të marrim një shembull tjetër. Para ca kohësh një tjetër legjendë urbane u përhap mes myslimanëve se gjoja një vajzë në një vend arab paska përdhosur Kurandin dhe më pas Allahu e paska shpërfytyruar atë në pamjen e një njeriu që më shumë i ngjante një qeni! Dhe madje për këtë gjë na tregohet edhe një foto si argument! Nga verifikimet e mëtejshme dilte se kjo foto nuk ishte gjë tjetër veçse pamje e një veprë arti bashkë me disa të tjera të ngjashme me të në një ekspozitë të hapur diku në një vend të botës.

Raste të tilla nëse do t'i vihemi verifikimit do të gjejmë për fat të keq me dhjetëra. P.sh. ne e dimë se dikur kanë ekzistuar njerëz me trup të mëdhenj, sepse të paktën dimë që Ademi, babai ynë i përbashkët ishte me trup të madh, siç thuhet në hadithet autentike të Profetit (alejhi salatu ue selam), mirëpo kjo nuk do të thotë që për të provuar ekzistencën e tyre të sajohen mashtrime fotografike me anë të manipulimeve me programe kompjuterike për të provuar këtë gjë, fakt ky që fatkeqësisht më ka rënë rasti ta ndesh shpesh në internet. Apo edhe plotë raste të tjera që ulërijnë që janë gënjeshtër, si guri që gjoja qëndron në ajër etj...etj...

Nëse të tilla gjëra janë vepër e jobesimtarëve, për tu tallur me ata që besojnë, atëherë tregon vërtetë nivelin e ulët intelektual të atyre që i besojnë këtyre mrekuillive false pa i verifikuar, e për më tepër të kujton hadithin e Profetit (alejhi salatu ue selam) që tregon sesa lehtë shumë njerëz do të bien preh e mashtrimeve të dexhalit, ndërkohë që ky mashtrues do të jetë shumë më aftë sesa të merret me të tilla trike të afta për të mashtruar vetëm çiliminjtë.

Por, nëse të tilla mashtrime bëhen nga besimtarët -gjë që lus Allahun të mos ndodh- për të provuar të vërtetën e tyre të besimit me të tilla gënjeshtër, siç bënin dikur disa njerëz që sajnin hadithe për të mbështetur fenë, atëherë më duhet t'u kujtojë atyre të gjitha ajetet dhe hadithet që kanë ardhur për të dënuar e denigruar gënjeshtërën dhe ata që gënjejnë, e që janë me dhjetëra. Mirëpo këtu do të citoj vetëm një hadith të Profetit (alejhi salatu ue selam) e që ka të bëjë jo me vetë gënjeshtarët, por me ata që i përcjellin këto gënjeshtër: "Kush tregon diçka të cilën ai e sheh se është gënjeshtër, atëherë ai është njëri prej gënjeshtarëve." (Trs. Muslimi)

Për të mos u zgjatur më tej më duhet të përsëris se jo vetëm lajmet që jepen kundra Islamit dhe myslimanëve duhet të hyjnë në sitën e verifikimit të vërtetësisë, por edhe ato që janë në favor të tyre, mes tyre padyshim edhe këto "mrekuilli" që na shfaqen aty dhe këtu apo që pretendohen për gjithë farë evlijash të vërtetë apo të rremë.

# Bota / Pluhur dhe kujtime të vrarësh në kampin e refugjatëve të Zatarit në Jordani

Nga Shaima HALILI



Shumë fëmijë që tashti jetojnë në kampin e refugjatëve në Zatarit kanë dëshmuar dhunën e pësuar në qytetet e tyre në Siri. Ajri vorbullon me zërat e fëmijëve, që këndojnë këngë fëmijësh fshati. Kjo mund të duket si një ditë normale lodrash për fëmijë kudo qofshin nëpër botë, por një vështrim më i afërt në fytyrat e lodhura dhe të pluhurosura të fëmijëve na rrëfejnë një histori ndryshe. Kjo nuk është një infermieri, nuk ka foto nëpër mure. Në fakt këtu nuk ka mure. Ky është një kamp refugjatësh dhe këta fëmijë që qëndrojnë në një rreth në tendë nuk kanë pasur mundësi të luajnë prej muajsh. Ata janë larguar nga Siria për shkak të dhunës dhe tashti po mundohen të mësojnë se si të zejnë shokë në këtë zonë të improvizuar të kampit. Pak larg kufirit me Sirinë në Jordani kampi i refugjatëve Zatarit mikpret më shumë se 14,500 refugjatë.

## MBËRRITJET E NATËS

Ky numër vazhdon të rritet me qindra dhe me disa ditë edhe me mijëra kalojnë kufirin për ditë. “Ne e kemi nisur me 500 refugjatë kur u hap kampi, tashti ne kemi 14,500,” thotë Ali Bibi, zyrtari ndërlidhës i agjencisë së refugjatëve të OKB-së në Jordani. Një kalim rekord refugjatësh brenda një nate prej 2,200 personash është pritur në kampin Zatarit, sipas kësaj agjencie. “Numri i tyre ndryshon sipas gjendjes politike dhe ushtarake në anën siriane. Ne presim 300-500 refugjatë në ditë mesatarisht. Ka ditë që numri i tyre bie në 50 dhe në ditë të tjera me mijëra, si në natën që kaloi,” na rrëfen ai. Në një shesh të vogël një grup fëmijësh janë mbledhur në dy rreshta dhe përpiqen të luajnë me njëri-tjetrit. Me sa duket i nxehti dhe pluhuri nuk i pengon ata dhe ata duken shumë të lumtur, që më në fund kanë mundësinë për të luajtur jashtë, diçka që nuk mund ta mendonin në vendin e tyre. Organizatorët e quajnë këtë pjesë të kampit “Zona miqësore e fëmijëve”. Aty është një grup tendash, ku fëmijët mund të luajnë dhe të miqësohen me njëri-tjetrit. Gjithashtu organizatorët e kanë planifikuar për ta përdorur atë në ndihmë të atyre, që kanë qenë dëshmitarë të skenave të tmerrshme gjatë konfliktit në Siri. “Ne po përpiqemi të ndërtojmë programe për të përmirësuar gjendjen shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve,” na shpjegon Seba Ebu Basla punonjëse sociale. “Ne po përpiqemi t’i

ndihmojmë ata për ato që kanë parë dhe të rikthehen në normalitet, nëse kjo gjë do të ishte e mundur të arrihej në këtë kamp,” vazhdon ajo. Debil Ghali një refugjat sirian nga qyteti i Humsit na tregon për tmerrret e përjetuara nga fëmijët e tij. “Zhurma e granatimeve është ajo çka i frikëson ato,” thotë ai. “Fëmijët e mi kanë parë gjëra të tmerrshme. Pjesë trupash, gjak, snajperato i urrejnë zhurmën e të shtënave. Ishte e frikshme, krejtësisht e frikshme. Ato rrinin në shtëpi gjithë ditën. Ato nuk mund të dilnin jashtë për të luajtur,” tregon ai.

## PËRTEJ IMAGJINATËS

Shumë nga këta fëmijë kanë kryer udhëtime tejet të lodhshme dhe disa herë edhe të frikshme me familjet e

tyre për të kaluar kufirin nga Siria në Jordani. “Ato na flasin për udhëtimin e tyre nga shtëpitë për këtu në kamp,” na thotë Seba Ebu Basla. “Detajet që japin janë të turbullta. Ne nuk jemi të sigurt nëse është realitet apo imagjinata e fëmijëve, për shkak të tmerrit të pafund. Disa prej tyre thonë, se mund të lëvizin vetëm në errësirë çka do të thotë, se ata janë fshehur diku gjatë gjithë ditës pa bukë e ujë. Aty thellë në kampin e Zatarit shihet një det i pafund tendash dhe pluhuri që i ka mbuluar ato e i ka kthyer nga të bardha në bezhë të çelët.

## MË MIRË SE MË PARË

Rastet më të vështira, të cilëve iu kërcënohet jeta janë transferuar nga kampi për në spitalet rajonale në bashkëpunim me ministrinë e shëndetësisë jordaneze. “Ne jemi të shqetësuar për ndonjë epidemi. Neve na duhet të jemi të kujdesshëm ndaj fruthit. Neve na duhet të jemi të kujdesshëm ndaj kolerës. Ne do të nisim shumë shpejt një fushatë imunizuese ndaj fruthit,” na thotë dr. Baptisti. Në një tendë të vogël qëndron i ulur Ahmed Jasini me tre fëmijët e tij. Ai po përpiqet të rimbushë celularin, që të ketë mundësi të lajmërojë të afërmit e vet në Siri. Ai e ka kaluar kufirin dhe është larguar nga qyteti i Derasë me gruan dhe fëmijët. “Po të mos i kisha pasur

ata, unë nuk do të isha larguar. Por ato janë traumatizuar aq shumë nga zhurma e plumbave dhe granatimeve, sa që unë mendoj se janë kompleksuar tashmë. Na u desh të iknim,” thotë ai, duke treguar fëmijët e vet. “Na u desh t’u thonim lamtumirë gjithçkaje dhe gjithkujt që njihnim, të afërmit dhe miqve të mi. Të iknim nga shtëpia jonë për në këtë tendë ishte shumë e vështirë, dhe na u desh disa ditë që të mësoheshim. Por kjo ishte më e mirë se sa të qëndronim atje. Ishte më mirë se më parë”.

<http://www.bbc.co.uk/news/world-middle-east-19368439>



Ahmed Jasini me fëmijët e tij

## Siri - Të strehuarit në Turqi mbi 80 mijë

Vazhdojnë arratisjet massive nga Siria. I ka kaluar të 80 mijë vetët numri i sirianëve që janë strehuar dhe mirëpritur në Turqi. Mësohet se ka rënie të rasteve të kalimit të kufirit për shkak të mungesës së vendeve dhe hapësirave në kampet që janë ngritur për strehimin e refugjatëve dhe me mijëra qytetarë sirianë presin në anën tjetër të kufirit. Vazhdojnë arratisjet nga Siria, vendi ku dhuna po përshkallëzohet çdo ditë e më shumë. Numri i sirianëve që sot ndodhen në Turqi i ka kaluar të 80 mijë vetët. Shtetasit sirianë janë strehuar dhe sistemuar në 8 qytete me çadra, një Qendër për Pranim të Përkohshëm dhe 1 qytet me kontejnerë që janë ngritur në zonat afër me kufirin sirian. Me kapërcimin e kapaciteteve në vendet e strehimit disa sirianë janë vendosur në konviktet e shkollave dhe sallat e sportit, që gjenden në provincat Gaziantep, Kahramanmarsh, Adana, Osmanije, Adijaman, Kilis dhe Malatja. Nga ana tjetër vazhdon ndërtimi i kampeve të reja me çadra në nënprefekturat Karkamish dhe Nizip të Gaziantepit dhe në Kahramanmarsh dhe Xhevdetije të Osmanijes. Kreu i Agjencisë së Menaxhimit të Fatkeqësive dhe Emergjencave (AFAD), Turan Erkoç në një deklaratë tha: “Pritet që kampi që do të ndërtohet në Marash të ketë kapacitet për të strehuar 15 mijë sirianë. Deri tani ka përfunduar gjysma

e punimeve për realizimin e projektit”. 1 mijë e 700 sirianë që për momentin ishin sistemuar në sallën e sportit në Kilis janë dërguar në këtë qytet të ri me çadra, që është në ndërtim e sipër. Parashikohet që ndërtimi i plotë i kampit të përfundojë në fund të këtij muaji. Nga ana tjetër sirianët vazhdojnë të kalojnë kufirin turk dhe të vijnë në nënprefekturën Ənxhypinar (Öncüpınar) të Kilisit. Bëhet e ditur se në anën tjetër të pikës së kalimit kufitar presin afërsisht 3 mijë qytetarë sirianë. Njoftohet se kalimet e kufirit janë ngadalësuar për një kohë të caktuar deri në hapjen e vendeve të reja për strehim për shkak të plotësisht të kapaciteteve ekzistuese në rajon. Opozitarët sirianë

gjithashtu bëjnë të ditur se numri i viktimave të masakrës së qytetit Deraja shkoi në 320. Ndërkaq janë publikuar edhe pamjet e reja të kësaj masakre. Në mesin e të vrarëve në afërsi të Damaskut gjenden gra dhe fëmijë. Njoftohet se shumica e të vrarëve janë ekzekutuar në shtëpitë e tyre. Ndërsa forcat e regjimit dhe opozitarët e akuzojnë njëri-tjetrit në lidhje me masakrën në fjalë. Në anën tjetër forcat e Esadit në operacionet e organizuara në vende të ndryshme të vendit kanë vrarë të paktën edhe 15 persona të tjerë. Bëhet e ditur që përlëshjet që jetohen në lagjet periferike të Damaskut kanë kaluar deri në qendër të qytetit.



## Opinion

# Masakra e Norvegjisë nga një i krishterë i krahut të djathtë tregon se terrori nuk ka ngjyrë apo besim

Nga Ebubekër KASEM\*



A mund ta merrni me mend, sikur ose musliman?... Kur terrori po shpalosej në kombin paqësor evropian të Norvegjisë të ashtuquajturit ekspert të terrorit u shfaqën nëpër ekranet televizive kohë e pa kohë. Ata villnin zjarr zemërimi e urrejtje, si të ishin dragonj që nxjerrin flakë e zjarr nga goja e tyre. Këta të ashtuquajtur "ekspertë" i përmbytën ekranet se si islamikët po pushtonin Evropën dhe Amerikën e Veriut, dhe sa të këqij janë Muslimanët. Pak orë më vonë këta ekspertë u turpëruan dhe u sikletosën. Ata u detyruan ta lënë skenën me

shumë qetësi dhe pa rënë në sy pasi vrasësi i dyshuar ishte anëtar i një krahu të djathtë ekstrem. Tonet e tyre ranë. Kishës së Anglisë dhe Vatikanit nuk iu kërkua ndonjë herë të lëshojnë ndonjë deklaratë ku të denoncohej ky akt, ku megjithëse kriminel i dyshuar kishte deklaruar se ishte një ithtar i një grupi ekstremist të Krishterë, feja nuk kishte të bënte aspak me atë gjë. Ndërsa po zhvillohet gjyqi i tij mjaft interesante është, se terroristi që e ka pranuar krimin po mundohet të provojë se është mendërisht i shëndoshë dhe që ai do ta bënte përsëri këtë gjë po ta kishte një shans tjetër; një përpjekje tjetër kërkon

ta paraqesë atë të duket mendërisht i sfiduar. Për më tepër që besimi i tij nuk përmendet asgjekund. Megjithëse vlerësime profesionale e kanë përcaktuar atë shëndoshë e mirë; një hulumtim tjetër iu bë më pas, duke u përpjekur të kundërshtojë përcaktimet fillestare.

Nëse do të kishte qenë musliman situata do të kishte qenë krejtësisht ndryshe. Nuk do të kishte qenë e nevojshme për vlerësime mendore ndaj tij. Zemërimi dhe emocionet do të arrinin kulmin. Feja e vrasësit do të ishte në qendër të vëmendjes. Të ashtuquajturit ekspertë të terrorit do ta kishin pasur të lehtë të bënin lidhjet ndërmjet këtij akti të urryer dhe vetë fesë. Ata do të kishin shkruar tashmë libra dhe do të pasuroheshin e do të bëheshin të famshëm për shkak të fresave që do të merrnin për të folur rreth njerëzve të përbindshëm, që quhen muslimanë. Jo vetëm që i dyshuari do të gjykohej, por e gjithë feja do të sillej zvarrë së bashku me të në karrigen e dëshmitarit. Udhëheqësit e komuniteteve do të rrinin zgjuar tërë natën, duke u përpjekur për të dalë me deklaratatë të fuqishme për të denoncuar aktin barbar. Mediat do të kishin vizituar xhamia e qendra islame të premtëve për të raportuar, nëse imamët do ta denonconin këtë akt. Udhëheqësit deri edhe do të qanin gjatë leximit të deklaratave denoncuese, dhe sikur imamëve t'iu ikte zëri duke ulëritur se Islami nuk ka të bëjë aspak me këto gjëra, mediat përsëri do të gjenin se këto deklaratatë

nuk do të ishin sa duhej të forta dhe jo aq me zë të lartë sa duhej.

Gjyqi që po zhvillohet në Norvegji duhet të jetë një zgjim për të gjithë njerëzimin. Ky është një zgjim për të treguar se terrorizmi nuk është vetëm një problem i brendshëm i shoqërisë muslimane. Njerëz të çmendur ka në çdo kulturë dhe shoqëri, ku disa e marrin përsipër vetë zbatimin e ligjit. Ne po jetojmë në një kohë ekstremizmi, kur njerëzimi e ka humbur sensin, sensin e orientimit. Ti mund të dëgjosh sot për sporte ekstreme, makijazh ekstrem, fitnes ekstrem e kështu me radhë. Deri edhe politikanët po sillen ekstrem këto ditë. Natyrshëm që edhe ndërmjet muslimanëve gjen të marrosur, që ndonjë herë veprojnë marrëzisht. Kështu veprojnë edhe të krishterët dhe komunitetet e tjera.

Sëmundja e ekstremizmit nuk ka ngjyrë apo besim. Ajo nuk ka kufij. Njerëzimi ka nevojë të zgjohet nga këto shpifje dhe të pyes veten, përse gjërat kanë dalë jashtë kontrollit?!

(Anders Breivik u shpall fajtor para pak ditësh për vrasjen e 77 personave të pafajshëm nga një gjykatë norvegjeze dhe u dënua me 21 vjet burgim. Sistemi i drejtësisë në Norvegji nuk e ka dënimin me vdekje.)

\* është kolumnist i <http://themuslim.ca> blogfaqe e muslimanëve kanadezë. <http://themuslim.ca/2012/04/20/the-norway-massacre-shows-terror-has-no-color-or-creed/>

## Debatet në internet dhe pasojat



Nga Roald A. HYSA

Mungesa e etikës dhe e qëndrimit konstruktiv është një nga të metat themelore e debateve të brendshme, por në veçanti e atyre që po zhvillohen në internet. Facebook-u, listat e e-mailave dhe blogjet e ndryshme e kanë rritur shpejtësinë e transmetimit të informacionit dhe të komunikimit publik, por etika e komunikimit ka mangësi të theksuara.

Mungesa e thelluar e mirëkuptimit dhe e tolerancës gjatë diskutimit dhe debatit është një nga defektet kryesore që vërehet. Kjo gjendje me solli ndërmend mexhliet e hershme, kur njerëzit e dijes (qoftë nxënës apo dijetarë, apo hoxhallarë) mblidheshin dhe garonin, se kush mund të ishte më i zoti në të shprehurit e mendimit të tij në lidhje me temën që diskutohet dhe arritja e rezultateve pozitive në përfundim të tyre.

Me këtë desha të them se këto lloj mexhliesh në mungojnë krejtësisht këtu në hapësirën tonë. Por një problem tejet i ndjeshëm së fundmi janë debatet që hapen në e-mail listat e internetit, si dhe së fundmi në rrjetin social të Facebook-ut, ku etika e debatit dhe e kundërshtimit të njëri-tjetrit lë shumë për të dëshiruar. Nuk po mundohem të sjell shembuj këtu, sepse me të vërtetë që do të ishte humbje kohe për të gjithë, kur pjesa më e madhe e jona janë të anëtarësuar nëpër listat e ndryshme. Sa për diskutimet në forumet tona internetare, ato nuk i plotësojnë kushtet e një mexhlii të vërtetë apo siç e parashoh unë, për disa arsye:

- 1: janë krejtësisht virtuale
  - 2: njerëzit që debatojnë në të shumtën e rasteve nuk e njohin nga afër njëri-tjetrin dhe kjo le shteg për të dëshiruar.
  - 3: personat që diskutojnë e bëjnë këtë nga vende të ndryshme dhe shumë herë reflektojnë pa dashje gabime me mosnjohjen e duhur të problemit për të cilin diskutohet apo debatohet.
  - 4: personat që diskutojnë meqenëse janë me formime të ndryshme shkollorë gjithmonë përpiqen t'i shikojnë gjërat sipas shkollimit që kanë marrë, apo po marrin (Një avokat sheh bazën ligjore të gjithçkaje, një imam e sheh nga pikëpamja fetare, një sociolog sipas shkollave përkatëse sociologjike etj.)
  - 5: nëse personat që diskutojnë e bëjnë këtë nga dy vende të ndryshme, bie fjala një shqiptar nga Amerika me një shqiptar nga Shkupi, apo Tirana, apo Prishtina, do të kishim nga një anë njërin nga diaspora dhe në anën tjetër me dy vendalinj puro, që kanë probleme të tjera nga ato të emigrimit, si dhe me një shqiptar që jeton në një qytet si Shkupi, ku më të paktën ky qytet banohet nga dy kombësi (pra, diskutimi mund të marrë një kolorit të paparë në bazë të këtij ekuacioni të tillë logjik.).
- Pasi numërova pesë arsye që e diktojnë krejt sfondin kuptimor të diskutimit dhe të debatit në forumet internetare, FCB apo e-mail listat do të merrja në shqyrtim vetë mexhliin, jo si etimologji fjale, por si

realitet.

Mexhlii ndërtohet në tre përmasa, le të përdorim këtë term të gjeometrisë jo-euklidiane. Njerëz të caktuar, që mblidhen në një vend të caktuar në një kohë të caktuar për të diskutuar për një temë apo problem të caktuar. E parë nën këtë këndvështrim mund të themi se rrethanat përbërëse janë të cunguara dhe nëse do të fillonim të bënim analogjitë, atëherë të gjithë së bashku do të vërenim:

1: a) Njerëzit lëvizin nga listat, ku mund të anëtarësohen dhe mund të largohen sipas dëshirës. Gjithashtu, megjithëse mund të jenë të anëtarësuar ata nuk marrin pjesë dhe diskutantët nuk mund ta dinë nëse heshtjen e tyre mund ta marrim si pohim apo abstenim, pra duke mos e ditur se kush është i pranishëm në atë diskutim-debat.

b) Pjesëmarrësit fizikë në një mexhlii marrin pjesë më gjallërisht edhe me heshtjen e tyre, duke u interpretuar kjo heshtje si praninë ndaj mendimit dominues.

2: Vendi: është i përbashkët, lista e-mailit dhe në mexhlii vendi ku do të diskutohet, por këtu mungon elementi i kontaktit fizik, pra, diskutimi apo debati zhvillohet pa pasur ndonjë kontakt fizik të drejtpërdrejt, për pasojë këtu analogjia nuk mund të themi se vendoset e plotë.

3: Koha: Diskutimi apo debati nuk mund të zhvillohet në të njëjtën kohë, pra, është shumë më i shtrirë në kohë.

4: Problemi apo tema e caktuar: Kjo është krejtësisht e përbashkët, por gjykimet dhe mendimet është e vështirë të jenë të përbashkëta dhe nuk mund të vijnë drejt unifikimit për shumë arsye të tjera (që kanë të bëjnë edhe me bindjet e njerëzve, të cilat janë shumë të rëndësishme, ndërsa nuk janë këto ato që po shqyrtojmë këtu), por që vështirësohen maksimalisht për të gjitha arsyet që i kam përmendur më sipër.

Gjithashtu një komponentë tejet e rëndësishme është etika e debatit dhe e mospërputhjes (ihtilafit), që i mungon në më të shumtën e rasteve debateve tona. Kështu nuk mund të habitemi, se si nëpër listat tona bisedat personalizohen krejt, kur nuk kanë të bëjnë me ne drejtpërdrejt, por me punët tona. Problemet tona janë po ato, mbeten po ato dhe do të mbeten po ato, po nuk i zgjidhëm në mënyrën e duhur, por edhe se ne deri tash nuk kemi përpjekur aq sa duhet, duke e drejtuar vëmendjen në bazë të një utilitarizmi ordiner që mund të vërehet qartas. Ndërkaq një pjesë e këtyre problemeve mund të shmangen shumë mirë, kur ne të reflektojmë gjallërisht etikën e lartë islame, të cilën neve duhet ta fitojmë vazhdimisht nëpërmjet shembullit të njeriut tonë më të dashur Muhamedit alejhi salatu ue selam, si dhe të shokëve të tij të afërt. Gjithashtu njohja e etikës së ihtilafit (mospërputhjes) do të ishte shumë me vend për të shtuar kapacitetin tonë të debatit.



## ARSIMIMI DHE EDUKIMI NËN VLERAT E ISLAMIT DHE NËN DRITËN E QYTETËRIMIT TË TIJ

Kopsht, Shkollë 9- vjecare, Shkollë e mesme

Tani SHKOLLA "Qëllimi i Jetës"  
edhe në qytetin e Durrësit

Për më shumë  
kontaktoni në nr. 0672608302



### SHKOLLA JONË OFRON:

Mësimdhënie në ambiente  
të ndara për djem dhe vajza

Mësim të dy gjuhëve të huaja  
(anglisht dhe arabisht)

Mësim Kurani dhe edukate  
islame jashtë programit mësimor

Konvikt për djem dhe vajza



Arsimim dhe edukim

Adresa: Rr: "Budi", Nd.5, H.1,  
400 m mbi "Qytetin Studenti"  
Cel: 0673086332 / 0682289208 ;  
Tel: 042377817

E-mail: [shkqellimijetes@yahoo.com](mailto:shkqellimijetes@yahoo.com)  
Web: [www.shkqellimijetes.com](http://www.shkqellimijetes.com)



# A-M-B-C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



[www.lidhjatregtareve.com](http://www.lidhjatregtareve.com)

## DYQANI I MISHIT HALLALL, Kombinat

tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri te firmes "Meka",  
me shumice dhe pakice, ofron qengja  
per kurbane dhe akika.



Adresa: Rr. Bedri Cullhaj, tek Goni, Xhamia e Kombinatit  
Tel: 042350569; Cel: 0672050070; Email: [agronxhepa@hotmail.com](mailto:agronxhepa@hotmail.com)